

V E N D I M

**PËR RI-VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
FUNKSIONARIT PUBLIKË Z.TËRMET PEÇI, KRYETAR I BASHKISË TEPELENË, NË ZBATIM
TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.03.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	BIBA-	Kryetar
Hysen	OSMANAJ-	Zv/kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edllra	JORGAQI-	Anëtare
Gëzim	VELESHNJA-	Anëtar
Klement	ZGURI-	Anëtar
Vera	SHTJEFNI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Ri-Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publikë z. Tërmet Peçi, kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 14, neni 15, i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 64, neni 144 i ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", është *organi kompetent* për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



- Deputet të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit të sipërcituar brenda afati, (4 gusht 2016) të përcaktuar në pikën 5 të Kreut VI të Vendimit të Kuvendit 17/2016, KQZ në mbledhjen e datës 29 korrik, shqyrtoi të dhënat e pasqyruara në formularët e vetëdeklarimit për funksionarët publikë, deputet, ministra që nuk janë deputet dhe kryetarët e bashkive.

Në përfundim të shqyrtimit KQZ, ndonëse nuk mori vendim, në mënyrë publike vlerësoi se asnjë prej funksionarëve publikë të verifikuar nuk përfshihej në kushtet për ndërprerjen e mandatit dhe ndalimin e ushtrimit të funksionit, edhe pse të gjithë anëtarëve iu bë e qartë se një numër i caktuar subjektësh nuk kishin deklaruar në formular të dhëna të caktuara si ndryshime gjenealitetesh apo dënime të mëparshme.

Në një kohë të dytë, Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet Sektorit të Verifikimit të Integritetit, i kërkoi KQZ-së, në zbatim të nenit 8, pika 2 të ligjit 138/2015, verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për 10 funksionarë publikë.

Pas verifikimit të formularit në përputhje me nenin 15, pika 1 të ligjit 138/2015 dhe Kreu VI, pika 6 Kreu V, pika 3, germa b e vendimit të Kuvendit 17/2016, KQZ vendosi t'ia kalojë rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme brenda 5 ditëve, në lidhje me mundësinë e evidentimit të të dhënave të tjera, të panjohura për KQZ. KQZ-ja gjithashtu i dërgoi Prokurorisë së Përgjithshme analizën e plotë të të dhënave në formularët e vetëdeklarimit, dhe ose në informacion shtesë, të bëra nga funksionarët pas afatit ligjor, vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore, Informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile si dhe vlerësimin e KQZ-së në lidhje me shqyrtimin e këtij dokumentacioni.

Referuar shkresës, nr.451/7.Prot, datë 13.03.2017, Prokuroria e Përgjithshme, ka dërguar në KQZ, vendimin "Për rezultatin të verifikimit" përkatësisht për z. Tërmet Peçi me detyrë kryetar i Bashkisë Tepelenë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 15 të ligjit 138/2015, Vendimit 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është institucioni kompetent për shqyrtimin e rezultateve të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga shqyrtimi i procesit të verifikimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme për funksionarin e sipërpërmendur rezulton se nuk ka asnjë të dhënë shtesë nga verifikimi i kryer, në lidhje me dënime me vendim gjyqësor të formës së prerë me vendime jopërfundimtare, masa sigurimit apo urdhëra dëbimi.

Rezultati i verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme është bërë në bazë të të dhënave të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka vënë në dispozicion me shkresat përkatëse, apo të dhëna të konfirmuara dhe nga vendimet gjyqësore dhe vërtetimet gjyqësore të cilat Prokuroria e Përgjithshme i ka administruar në organet kompetente (Gjykata dhe Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve).

Në përfundim, rezulton se nga verifikimi i kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka të dhëna shtesë përveç sa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka patur në dispozicion prej kohësh.

Vlerësimi i Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me këto të dhëna është se: "subjekti deklarues, z. Tërmet Peçi përfshihet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit aktual si kryetar bashkie të parashikuara në vendimin e Kuvendit 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



Vlerësimi i Prokurorisë bazohet në Kreun, III, pika 3, ç) të vendimit 17/2016 të Kuvendit, sipas të cilit formulari, (që plotësohet dhe firmoset nga subjekti vetëdeklarues), përmban një rubrikë ku detyrimisht pasqyrohet se "Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të sjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/apo emërimi nga funksioni publikë".

Sipas arsytimit të Prokurorisë, ky subjekt, duke nënshkruar në faqen e dytë të formularit të miratuar me vendimin 17/2016 të Kuvendit, mbajnë përgjegjësi të plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota në lidhje me të kaluarën e tij kriminale. Rrjedhimisht, fakti që në formularin e depozituar *brenda afatit* nuk është pasqyruar asnjë e dhënë në lidhje me një dënim me vendim të formës së prerë e bën këtë subjekt të përfshihet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit, formularit të vetëdeklarimit, të depozituar në datë 21.04.2016, Informacionit plotësues të depozituar më datë 10.06.2016, vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se, z. Tërmet Peçi ka qenë i dënuar me gjobë:

- ✓ 100.000 lekë gjobë me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr.21, datë 27.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë, për kryerjen e veprës penale, "Përdorim i Dokumentave të Fallsifikuara", parashikuar nga neni 186/1, i Kodit Penal. Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar.

Me shkresën nr.2633, datë 10.06.2016, z. Tërmet Peçi ka kërkuar riparaqitjen e formularit të vetëdeklarimit, duke shënuar të dhëna plotësuese në lidhje me dënimin me 100.000 lekë gjobë me vendim gjyqësor të formës së prerë nr.21, datë 27.04.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë, për kryerjen e veprës penale "Përdorim i Dokumentave të Fallsifikuara", nga neni 186/1, i Kodit Penal. Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar.

Kodi i Procedurave administrative në nenin 144 "Rishikimi", parashikon se:

1. Rishikimi është mjete ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod.
2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të Procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 29 korrik 2016, nuk e shqyrtoi duke nxjerr konkluzionin e verifikimit me një akt administrativë, çështjen e mosdeklarimit, brenda afatit të përcaktuar në nenin 15 të ligjit 138/2015 në formularin e vetëdeklarimit të një dënimi me vendim të formës së prerë me riedukim nëpërmjet punës. Referuar nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative, duke qenë se sipas rezultatit të verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme ka disa të dhëna të reja, të cilat kanë rëndësi për çështjen duke e zgjidhur atë në themel, dhe në mënyrë përfundimtare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të rishikojë vendimmarrjen e tij të datës 29 korrik 2016, në lidhje me verifikimin e formularit të vetëdeklarimit për funksionarin publikë z. Tërmet Peçi.

Në lidhje me arsytimin e vendimit nga Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shprehet se:

Për sa i përket vlerësimit të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Tërmet Peçi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duhet t'i referohet: Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligji nr.137/2015 "Për disa shtesa në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar, konkretisht neni 6/1 dhe 45, paragrafi i tretë.



Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Neni 6/1

"Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publikë në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publikë, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit."

Neni 45, paragrafi i tretë

"përfshihen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit".

Ligji 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe konkretisht nenit 2, nenit 3, nenit 5.

Neni 2

Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publikë 1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për:

a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal;

b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/c, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal;

c) kryerjen e një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim;

ç) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

2. Ndalimi i parashikuar nga pika 1, e këtij neni, zbatohet edhe ndaj personave:

a) që janë dënuar me një vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, apo për të cilët është vendosur masë sigurimi personal dhe/ose është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar nga autoritetet e një prej këtyre shteteve, për kryerjen apo tentativën e kryerjes së një prej veprave penale, të parashikuara në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni. Për personat që plotësojnë kushtet e këtij paragrafi, ndalimet zbatohen në përputhje me pikën 5, të nenit 10, dhe pikën 1, të nenit 16, të këtij ligji;

b) që janë dëbuar nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, në lidhje me një prej rasteve të parashikuara në pikën 1, shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, apo janë dëbuar për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit përkatës.

Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



Neni 3

Ndalimi për t'u emëruar në një funksion publikë

1. Për veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, personi nuk mund të emërohet apo zgjidhet në funksionet publike si më poshtë:

- a) në organe kushtetuese apo të krijuara me ligj;
- b) gjyqtarë ose prokurorë;
- c) në postin e zëvendësministrit apo të njëvlershëm me të;
- ç) në postin e prefektit;
- d) funksionarë politikë në kabinetet e drejtuesve të çdo Institucioni kushtetues apo të krijuar me ligj;
- dh) në Shërbimin Informativ Shtetëror dhe shërbime të tjera informative;
- e) në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik si dhe drejtues të çdo niveli ne administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil;
- ë) në Policinë e Shtetit;
- f) ushtarakë të forcave të armatosura, si dhe
- g) në çdo post drejtues të kompanive që zotërohen plotësisht apo në maxhorancë ose administrohen nga shteti.

Neni 5

Vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave

1. Personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3, të këtij ligji, duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar.

2. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit.

3. Formulari i vetëdeklarimit plotësohet vetëm nga personi që është subjekt i këtij ligji. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal".

Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Neni 64

E drejta e plotësimt, ndryshimit dhe e tërheqjes së kërkesës.

1. Një palë që ka dorëzuar një kërkesë mund ta plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

Në rastin e z. Tërmet Peçi, i cili nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit një dënim me gjobë, KQZ duhet t'i jap përgjigje, pyetjeve:

1. A kanë detyrim për deklarim funksionarët publikë që parashikon ligji 138/2015 të deklarojnë çdo lloj dënimi edhe përtej parashikimeve kushtetuese dhe ligjore?
2. A kanë të drejtë funksionarët publikë të bëjnë plotësim apo ndryshim të kërkesës fillestare, kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes së parë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i referohet së pari Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe më pas ligjit 138/2015. Kushtetuta, referuar nenit 45 paragrafi 3 të saj dhe ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 2 të tij parashikon se, përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës



Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për disa vepra penale të përcaktuar në mënyrë shteruese. Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore të cituara më sipër, funksionarët publikë kanë detyrimin për të deklaruar të dhëna për dënime me burgim me vendim të formës së prerë, për me jo më pak se 6 muaj, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Funksionarët publikë nuk kanë detyrimin sipas nenit 2 të ligjit 138/2015 të deklarojnë dënime me riedukim nëpërmjet punës.

Referenca e organit të prokurorisë, në lidhje me rastin në fjalë, nuk bëhet në mbështetje të parashikimeve kushtetutës dhe të ligjit, por bëhet në lidhje me vendimin e Kuvendit 17/2016, pika 3, germa "ç" dhe formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues. Pikërisht kërkesa në rubrikën 1 të formularit të vetëdeklarimit i miratuar nga Kuvendi, është në tejkalim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Interpretimi i organit të prokurorisë bie ndesh haptazi me parashikimet e nenit 3 të ligjit 138/2015 ku janë caktuar shprehimisht rastet e ndalimit për t'u emëruar në një funksion publikë dhe referenca ligjore për ndalimin për emërim apo zgjedhje në funksionet publike të cituara në këtë dispozitë i referohet po ligjit dhe vetëm nenit 2, pika 1 të tij.

Neni 5 i ligjit parashikon:

- subjektet që kanë detyrimin për të deklaruar dhe
- përcakton se çfarë detyrimesh kanë këta persona.

Sipas kësaj dispozite detyrimi i subjekteve është që të plotësojnë dhe të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit duhet të deklarojnë mosegzistencën e shkaqeve për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur apo për të mos u emëruar. Shkaqet për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur apo për të mos u emëruar janë vetëm shkaqet e përcaktuara në nenin 2 të ligjit 138/2015. Të tilla shkaqe dispozitat e sipërcituara kanë përcaktuar dënimin me burgim jo me pak se 6 muaj për kryerjen e një krimi brenda apo jashtë Shqipërisë, pasja e një mase sigurimi personal ose një urdhër kërkimi ndërkombëtar si dhe dëbimi nga territori i një shteti anëtar të BE, SHBA, etj.

Kjo do të thotë se subjektet vetëdeklaruese nuk kanë detyrimin që të deklarojnë çfarë do lloj dënimi me burgim, dënimi me gjobë apo çfarë do lloj tjetër dënimi, përveç atyre dënimeve për kryerjen e një krimi, me burgim për jo më pak se 6 muaj, si dhe masat e tjera të parashikuara nga neni 2, pika 2 e ligjit 138/2015.

Në asnjë rast ligji 138/2015 nuk parashikon se subjekti deklarues duhet të deklarojë gjithçka dhe çdo gjë, por ligji në parashikimet e tij është selektiv dhe shterues, sepse e lidh në mënyrë të posaçme detyrimin për deklarim sipas llojit të veprës penale që ka kryer subjekti vetëdeklarues dhe gjithnjë brenda rrethit të atyre veprave penale që vetë ligji 138/2015 parashikon. Në rastin e subjektit vetëdeklarues z. Tërmet Peçi Kryetar i Bashkisë Tepelenë dënimi me gjobë për veprën penale "Përdorim i Dokumentave të Falsifikuar", parashikuar nga neni 186/1, i Kodit Penal, nuk përfshihet në parashikimet dhe ndalimet e nenit 2 të ligjit 138/2015.

Vendimi i Kuvendit 17/2016, pika 3, germa "ç" parashikon shprehimisht se: "*pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publikë*".

Pikërisht ky është parashikimi i vendimit të Kuvendit ku mbështetet edhe argumenti se "subjekte të caktuara ndodhen në kushtet e ndalimit për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publikë", nga ana e organit të prokurorisë. Referenca formale dhe në mënyrë të shkëputur në këtë pikë të vendimit të Kuvendit është e gabuar sepse:

Së pari, nëpërmjet këtij parashikimi gjendemi në situatën që vendimi i Kuvendit ka parashikuar një rregull material, që në fakt, nuk është detyra e një vendimi që ka dalë për zbatim të ligjit dhe të Kushtetutës, të parashikojë rregulla materiale.



Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Një parashikim i tillë është tipik ligjor. Sipas hierarkisë së normave të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta vendimi në fjalë nuk mund të zëvendësojë ligjin e aq më tepër Kushtetutën.

Sipas ligjit 138/2015 e konkretisht nenit 6 të tij, pika 1, "Kuvendi miraton me vendim rregullat e detajuara dhe afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve, si dhe për marrjen e masave për zbatimin e ndalimeve të parashikuara nga ky ligj". Pra, me fjalë të tjera nuk mundet dot Vendimi, qoftë ky dhe i miratuar nga Kuvendi të parashikoj ndryshe nga sa ka parashikuar ligji, sikurse ka ndodhur në rastin në fjalë. Tejkalimi i parashikimeve nga ana e një akti më të ulët në hierarkinë e normave ligjore nuk mund ta bëjë të ligjshëm këtë parashikim.

Hierarkia e normave ligjore është parashikuar shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e konkretisht në nenin 116 të saj duke renditur si më poshtë:

"AKTET NORMATIVE Neni 116 i saj:

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) Kushtetuta;
- b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c) ligjet;
- ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

Vendimi i Kuvendit në këtë rast nuk përmendet fare, por duke konsideruar delegimin që ka bërë vetë ligjvënësi, theksojmë se, sa më sipër, primati i normës ligjore është i padiskutueshëm në raport me një normë tjetër më të ulët se ajo në hierarkinë e normave.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se parashikimi i vendimit të Kuvendit 17/2016, e konkretisht, pika 3, germa "ç", se: "pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik", do të duhet të zbatohet gjithnjë nëse pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta që kanë lidhje me veprat penale që parashikon ligji dhe në asnjë rast përtej tij.

Neni 2 i ligjit 138/2015 nuk e parashikon veprën penale "Përdorim i Dokumentave të Fallsifikuara", parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal si nen që të përfshihet në fushën e ndalimit për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publikë, pra një argument shtesë për mospasjen e detyrimit të subjektit në fjalë për të deklaruar një vendim gjykate për një veprë penale që nuk përshihet në rrethin e veprave penale që parashikon ligji 138/2015.

Sa më sipër është e lidhur ngushtësisht edhe me parashikimet e nenit 1 të ligjit 138/2015 "Qëllimi dhe objekti" ku parashikohet shprehimisht se: "1. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publikë të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurle ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar PËR KRYERJEN TË KRIMEVE, SIPAS KËTJË LIGJIT".

Pra, edhe vetë qëllimi i ligjit lidhet me parashikimet e ndalimeve të parashikuara shprehimisht prej tij dhe vetëm për veprat penale që vetë ky ligj parashikon dhe jo përtej tij.

Sa më sipër është argumentuar, reflektohet edhe në formularin e vetëdeklarimit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Në formularin e vetëdeklarimit në faqen 3, pika III, pyetja 1 është si vijon:

Ekstrakt i formularit të vetëdeklarimit:



Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
			Neni	Lloji

Në fakt, sikurse vihet re, pyetja është vërtet nëse subjekti është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, por përmbajta e saj zbërthehet në tabelën që vijon dhe nuk duhet të merret e shkëputur prej saj. Dhe konkretisht, subjekti mbart detyrimin për të deklaruar gjykatën (e huaj apo shqiptare) që ka dhënë vendimin, numrin dhe datën e vendimit si edhe, në nënndarjen e tretë parashikon detyrimin për të deklaruar llojin e dënimit me burgim, gjë që shkon në rrjedhën logjike edhe të Kushtetutës edhe të ligjit 138/2015. Në asnjë rast subjekti vetëdeklarues, edhe sipas logjikës se si është ndërtuar edhe formulari nuk ka detyrimin të deklarojë një vendim gjyqësor me riedukim nëpërmjet punës.

Prokuroria vjen me konkluzionin se subjekte të caktuara përfshihen në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit pikërisht nën këtë parashikim të Vendimit të Kuvendit, duke injoruar kushtetutën dhe ligjin. Pra, thënë ndryshe, penalizimi në rastin konkret nga ana e organit të prokurorisë bëhet mbi bazën e një akti që ka dalë në bazë e për zbatim të ligjit, është njësoj sikur prokurori të bazojë ngritjen e akuzës duke u bazuar në Kodin e Procedurës Penale që është mjete nëpërmjet të cilit prokurorja shkon drejt realizimit të dënimit të parashikuar, ky i fundit nga Kodi Penal, ose për të ruajtur hierarkinë me rastin në fjalë, me një udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



Të gjitha rendet shoqërore të shoqërisë njerëzore, nga më i thjeshti e deri tek ata më diktatorialët janë mbështetur mbi rregullat të shkruara apo të pashkruara qofshin ato. Dhe rregulli në këtë rast është ajo çfarë Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar shprehimisht

"Nuk ka dënim pa ligj neni 7 i KEDNJ, "Vetëm ligji mund të urdhërojë një ndëshkim". Këto janë parime esenciale të shtetit të së drejtës.

Prokuroria e Përgjithshme ka tejkaluar parashikimet e ligjit 138/2015 dhe të vendimit të Kuvendit 17/2016 edhe në kuptim të mënyrës së ushtrimit të detyrës nga ana e saj. Konkretisht sipas parashikimeve të pikës 5, të Kreut V të vendimit të Kuvendit 17/2016.

"Për efekt të verifikimit nëse personi është apo jo në kushtet e ndallmeve, sipas neneve 2 dhe 3, të ligjit 138/2015, "Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Prokuroria e Përgjithshme vepron si më poshtë:

a) Për personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit gjyqësor të formës së prerë;

II) verifikohet nëse dënimi është dhënë për ndonjë nga veprimet apo mosveprimet që përmbajnë veprat penale të përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 2, të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Të njëjtin detyrim parashikon vendimi i Kuvendit edhe për rastet e personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas germave "b", "c", "ç" "d" dhe "dh". Pra, është detyrë e organit të prokurorisë t'i referohet ligjit dhe vetëm ligjit, gjë të cilën sikurse shpjegoam më sipër, prokuroria nuk e ka bërë.

Në rastin konkret të z. Tërmet Peçi, duke mos e shënuar brenda afatit ligjor për dorëzimin e formularit, ka deklaruar se nuk ka asnjë shkak për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur, apo mos emëruar sepse pavarësisht se ai është dënuar me një vendim të formës së prerë me gjobë, ky lloj dënimi nuk është shkak për të mos u zgjedhur, mos u emëruar apo për të humbur funksionin që ka.

Në lidhje me faktin se: KQZ ka pranuar plotësim dokumentacioni në lidhje me formularin e vetëdeklarimit tej afatit ligjor, por brenda afatit brenda të cilit KQZ kishte detyrimin për të shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga subjektet që mbartnin detyrimin për vetëdeklarim në përputhje me ligjin 138/2015, KQZ konstaton se: Procedura e ndjekur nga ana e KQZ është në përputhje me parashikimet e ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë e konkretisht parashikimi i nenit 64 të tij ku parashikohet shprehimisht e drejta e plotësimi, ndryshimit dhe e tërheqjes së kërkesës. "Një palë që ka dorëzuar një kërkesë mund ta plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare". Pranimi i dokumentacionit plotësues është në përputhje me parashikimet e nenit 1 Qëllimi i ligjit. "Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor". Parim mbi të cilin mbështetet edhe parashikimi i pikës 3, të Kreut të parë të vendimit të Kuvendit 17/2016 ku parashikohet shprehimisht se: "Organet e përfshira në procesin e verifikimit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, sipas ligjit, ndjekin parimet e mëposhtme: a) ligjshmërisë dhe procesit të rregullt ligjor; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; c) objektivitetit, profesionalizimit dhe efikasitetit; ç) transparencës dhe rritjes



Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

së besimit të publikut në organet shtetërore; d) pavarësisë dhe paanshmërisë". Pranimi i dokumentacionit është në funksion edhe të frymës së vetë ligjit 138/2015. Kështu, ligji është mbështetur në një proces vetëdeklarimi dhe në të gjitha rastet e mbështet penalltetin e parashikuar prej tij tek refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit dhe kjo, sipas parashikimeve të nenit 5 të ligjit 138/2015. Në rastet në fjalë nuk bëhet fjalë për refuzim për të deklaruar apo mosparaqitje e formularit, përkundrazi, formulari është dorëzuar brenda afatit ligjor dhe në një moment të dytë është kërkuar shtesa dhe plotësimi i tij gjithnjë në funksion të parimit të vetëdeklarimit që parashikon vetë ligji.

Në kushtet kur vendimi i kuvendit nuk e parashikonte këtë moment me të drejtë KQZ-ja, i është referuar parimeve dhe rregullave të Kodit të Procedurave Administrative sa më shpër. Është në frymën e legjislacioni tone në përgjithësi ky fakt. Edhe në Kodin e Procedurës Civile parashikohet shprehimisht se "Padtësi gjatë hetimit gjyqësor ka të drejtë edhe pa e ndryshuar shkakun ligjor të padisë, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e padisë".

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi analizoi rrethanat e çështjes, dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të z. Tërmet Peçi, vlerëson se z. Tërmet Peçi me detyrë Kryetar i Bashkisë Tepelenë nuk është në kushtet e parashikuara nga neni 2 i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 14, nenin 15, të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 64, neni 144 "Kodi i Procedurës Administrative".

VENDOSI:

1. Të shpall të pavlefshëm dhe përfundim të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë z. Tërmet Peçi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Denar	BIBA-	Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Gëzim	VELESHNJA-	Anëtar

Abel (Kryetar)
SK (Kunder)
Elez (Anëtare)
Gëzim (Kunder)



Nr. 91 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për RI-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".